**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada – Government***

# UDHËZIM ADMINISTRATIV MASHT NR. 02 /2015 MBAJTJA E ZGJEDHJEVE STUDENTORE DHE ZGJEDHJA E KËSHILLAVE NË NJËSI AKADEMIKE NË UNIVERISTETIN "FEHMI AGANI" TË GJAKOVËS

# ADMINISTRATIVNA UREDBA MONT BR. 02 /2015 ODRŽAVANJE OPŠTIH STUDENTSKIH IZBORA I IZBOR ORGANA I SAVETA AKADEMSKE JEDINICE UNIVERSITET U ĐAKOVICI "FEHMI AGANI"

# DRAFT ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MEST NO. 02 /2015 KEEPING STUDENT ELECTIONS AND THE ELECTION OF BODIES AND COUNCILS IN ACADEMIC UNITS AT THE UNIVERSITY "FEHMI AGANI" OF GJAKOVA

| | | |
|---|---|---|
| Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, në mbështetje të neneve 4, 21 dhe 22 të Ligjit nr. 03/L-189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës dhe nenet 1 dhe 6 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, duke u bazuar në nenin 8 paragrafi 1.4, shtojcën 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive 22.03.2011, nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë nr. 09/2011 (Gazeta zyrtare nr. 15, 12.09.2011), nxjerr: | Ministar obrazovanja, nauke i tehnologije, na osnovu člana 4, 21 i 22 Zakona br. 03/L-189 o državnoj upravi Republike Kosova i član 1 i 6 Zakona o visokom obrazovanju Republike Kosova, na osnovu člana 8 stav 1.4, prilog 6 Pravilnika br. Uredbe br. 02/2011 za oblast administrativne odgovornosti Ured premijera i ministarstva 22.03.2011, član 38 stav 6 Poslovnika o radu Vlade br. 09/2011 (Službeni glasnik br. 15.12.09. 2011), izdaje: | Minister of Education, Science and Technology, pursuant to articles 4, 21 and 22 of the Law no. 03/L-189 for the state administration of the Republic of Kosova and articles 1 and 6 of the Law on Higher Education in the Republic of Kosova, being based in article 8 paragraph 1,4, appendix 6 of the Regulation no. 02/2011 for administrative responsibility fields of Prime Minister's Office and Ministries 22.03.2011, article 38 paragraph 6 of the Government's Rule of Procedure no. 09/2011 (official gazette no. 15, 12.09.2011, issue: |
| **UDHËZIM ADMINISTRATIV** | **ADMINISTRATIVNA UREDBA** | **ADMINISTRATIVE INSTRUCTION** |
| **Mbajtja e zgjedhjeve studentore dhe zgjedhja e organeve dhe këshillave në njësi akademike në Universitetin "Fehmi Agani" të Gjakovës** | **Održavanje opštih studentskih izbora i izbor organa i saveta akademske jedinice Univerzitet u Đakovici "Fehmi Agani"** | **Keeping student elections and the election of bodies and councils in academic units at the University "Fehmi Agani" of Gjakova** |
| **NUMËR:** 02/2015<br>**DATË:** 27.02.2015 | **BROJ:**<br>**DATUM:** | **NUMBER:**<br>**DATE:** |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 1**<br>**Qëllimi**<br><br>Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ, është krijimi i bazës ligjore për mbajtjen e zgjedhjeve studentore dhe zgjedhjen e organeve dhe këshillave në njësi akademike në Universitetin "Fehmi Agani" në Gjakovë.<br><br>**Neni 2**<br>**Zgjedhjet studentore në Universitetin "Fehmi Agani" në Gjakovë**<br><br>1. Këshilli i Përkohshëm Drejtues, është i obliguar që në afat prej 15 ditësh nga miratimi i këtij Udhëzimi administrativ, të miratoj rregulloren për zgjedhjet studentore dhe të caktoj një afat 20 ditor për regjistrimin e organizatave studentore në Ministrinë e Administratës Publike (MAP).<br><br>2. Këshilli i përkohshëm Drejtues obligohet:<br><br>2.1. Të përgatis planin dinamik të zgjedhjeve studentore;<br><br>2.2. Të caktoj datën e zgjedhjeve në kohë të përshtatshme me qëllim të pjesëmarrjes sa | **Član 1**<br>**Cilj**<br><br>Cilj Administrativne uredbe, je stvaranje zakonske osnove za održavanje studentskih izbora i izbor organa i saveta akademske jedinice Univerzitet "Fehmi Agani" u Đakovici<br><br>**Član 2**<br>**Opšti izbori na Univerzitet "Fehmi Agani" u Đakovici**<br><br>1. Privremeni upravni savet, je obavezan da u roku od 15 dana od usvajanja ove Administrativne uredbe, usvoji Uredbu o studentskim izborima i da odredi rok od 20 dana za registraciju studentskih organizacija u Ministarstvu javne uprave (MJU).<br><br>2. Privremeni ipravni savet se obavezuje:<br><br>2.1. Da pripremi dinamični plan studentskih izbora;<br><br>2.2. Da odredi dan izbora u prikladno vreme sa ciljem za što veće učešće | **Article 1**<br>**The purpose**<br><br>The purpose of this Administrative instruction is creation of legal base on keeping the student elections and the election of bodies and councils in academic units at the University "Fehmi Agani" in Gjakova.<br><br>**Article 2**<br>**Student elections at the University "Fehmi Agani" in Gjakova**<br><br>1. Interim Governing Council is obliged within 15 days from the adoption of this Administrative instruction, to adopt regulation for student elections and to set a 20 days deadline on enrolment of student organizations in the Ministry of Public Administration (MPA).<br><br>2. Interim Governing Council is obliged:<br><br>2.1. To prepare dynamic pan of student elections;<br><br>2.2. To set the election date at appropriate time, with intention of students' more |

| | | |
|---|---|---|
| më masive të studentëve në zgjedhje;<br><br>2.3. Të nxjerrë vendime tjera për tejkalimin e situatave të veçanta të cilat mund të krijohen gjatë procesit zgjedhor;<br><br>2.4. Këshilli i Përkohshëm Drejtues, obligohet që të kujdeset për mbarëvajtjen e zgjedhjeve studentore në këtë universitet, të shpallura sipas rregullores për zgjedhje, duke respektuar afatet dhe procedurat e zhvilluara sipas vendimit të Këshillit të Përkohshëm Drejtues. | studenata na izborima;<br><br>2.3. Da donese i druge odluke o prevazilaženju posebnih situacija koje mogu nastati u toku izbornog procesa;<br><br>2.4. Privremeni upravni savet, je obavezan da se stara za održavanje studentskih izbora, objavljenim prema uredbi za izbore, poštujući vremenske rokove i procedure prema odluci Privremenog upravnog saveta. | massive participation in elections;<br><br>2.3. To issue other decisions to overcome special situations, which can be created during the election process;<br><br>2.4. Interim Governing Council is obliged to take care for student election progress at this university promulgated according to regulations for elections, by respecting deadlines and developed procedures by the decision of the Interim Governing Council. |
| **Neni 3**<br>**Zgjedhjet e përgjithshme në Universitetin "Fehmi Agani" në Gjakovë**<br><br>1. Këshilli i Përkohshëm Drejtues i Universitetit "Fehmi Agani" në Gjakovë, obligohet që në afat prej 15 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij Udhëzimi administrativ:<br><br>1.1. Të nxjerrë rregulloren për zgjedhjet në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë nr. 04/L-037;<br><br>1.2. Të shpallë zgjedhjet e përgjithshme në | **Član 3**<br>**Opšti izbori na Univerzitet "Fehmi Agani" u Đakovici**<br><br>1. Privremeni upravni savet Univerziteta "Fehmi Agani" u Đakovici, obavezuje se da u roku od 15 dana od dana stupanje na snagu ove Administrativne uredbe:<br><br>1.1. Da donese pravilnik o izborima u skladu sa Zakonom o visokom obrazovanju br. 04/L-037;<br><br>1.2. Da objavi opšte izbore na Univerzitet | **Article 3**<br>**General elections in the University "Fehmi Agani" in Gjakova**<br><br>1.Interim Governing Council of University "Fehmi Agani" in Gjakova, is obliged that within 15 days from entry into force of this administrative instruction:<br><br>1.1. To issue regulation on elections in compliance with the Law on Higher Education no. 04/L-037;<br><br>1.2. To announce general elections at the |

| | | |
|---|---|---|
| Universitetin "Fehmi Agani" në Gjakovë; | "Fehmi Agani" u Đakovici; | university "Fehmi Agani" in Gjakova; |
| 1.3. Të përgatisë planin dinamik të zgjedhjeve me synim që zgjedhjet të përfundojnë në afat optimal dhe të arsyeshëm; | 1.3. Da pripremi dinamični plan izbora sa ciljem da se izbori završe u optimalnom i razumnom roku; | 1.3. To prepare dynamic plan of elections with aim that elections to end in optimal and reasonable deadline; |
| 1.4. Të nxjerrë vendime tjera për tejkalimin e situatave të veçanta të cilat mund të krijohen gjatë procesit zgjedhor. | 1.4. Da donese i druge odluke za prevazilaženje specifičnih situacija koje mogu nastati tokom izbornog procesa. | 1.4. To issue other decisions to overcome special situations, which can be created during the election process |
| **Neni 4**<br>**Dispozitat kalimtare** | **Član 4**<br>**Prelazne odredbe** | **Article 4**<br>**Transitional provisions** |
| Strukturat e dala nga zgjedhjet në Universitetin "Fehmi Agani" në Gjakovë sipas këtij Udhëzimi administrativ, kanë mandat të plotë. | Strukture kao rezultat izbora na Univerzitet "Fehmi Agani" u Đakovici prema ovoj Administrativnoj uredbi imaju puni mandat. | All structures arising from elections at the university "Fehmi Agani" in Gjakova under this administrative instruction are fully mandated. |
| **Neni 5**<br>**Dispozitat shfuqizuese** | **Član 5**<br>**Van snažene odredbe** | **Article 5**<br>**Repealing provisions** |
| Ky Udhëzim administrativ shfuqizon Udhëzimin administrativ nr. 36/2014 të dt. 03.12.2014. | Ova Administrativna uredba stavlja van snage administrativnu uredbu br.36/2014 datuma 03.12.2014. | This administrative instruction repeals the administrative instruction no. 36/2014 of the date 03.12.2014 |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 6**<br>**Hyrja në fuqi**<br><br>Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Ministri.<br><br>**Prof. dr. Arsim Bajrami**<br><br>Ministër i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë | **Član 6**<br>**Stupanje na snagu**<br><br>Ova Administrativna uredba stupa na snagu na dan njenog potpisivanja od strane ministra.<br><br>**Prof. dr. Arsim Bajrami**<br><br>Ministar obrazovanja, nauke i tehnologije | **Article 6**<br>**Entry into force**<br><br>This administrative instruction enters into force on the day of signature by the minister<br><br>**Prof. dr. Arsim Bajrami**<br><br>Minister of Education, Science and Technology |